34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkakuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësise se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësise se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësise se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

### **Neni 35 Pranimit përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **Shkelja e kontratës dhe shkëputja**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

#### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre në punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dënave të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

#### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 “Force Madhore” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashkueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

#### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

#### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

**Neni 41****Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve****Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 43****Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**PJESA III E KONTRATES****KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Përkufizimet	1.3	Sipas kushteve të përgjithshme.
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: <b>10% të vlerës së kontratës</b> , për kohëzgjatjen e periudhës prej: <b>12 muaj + 30 ditë</b> , nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definiuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, sëbashku me materialin dhe impiantin gjer në kosoton e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar; (d) Ndëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar,
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <b>5 ditë kalendarike</b> nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <b>5 ditë kalendarike</b> nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të Projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë nga dita e caktuar në planin e menaxhimit nga menaxheri i projektit.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonesave të lejuara nga organi mbykqyrës. Kontrata është: <b>12 muajsh</b> dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.

Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve te përgjithshme te kontratës. <b>Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga Z.K.A – ja.</b>
Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në Euro. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacion.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% të vlerës së kontratës. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion nga një bankë e licencuar në Kosovë, ose Kompani e sigurimesh e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës “me kërkesë”. Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësi mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve do të jetë: 24 muaj. Periudha e përgjegjesisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<b>Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë.</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

## Paramasa dhe Paralogaria

Z

Verejtje: Kontraktori duhet patjetër t'iu referohet Specifikimeve Gjenerale dhe detaleve. Çmimet duhet të përfshijnë furnizimin, transportin dhe instalimin/finalizimin e të gjitha materialeve. Kontraktori duhet të dorëzojë Deklaratat e Konformitetit për të gjitha materialet e përdorura në këtë projekt. Për të gjitha punët e ekzekutuara, patjetër duhet të bëhen testet paraprake.

POS.	1. PUNËT PREGADITORE				
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	<b>Përshkrimi i pozicionit</b>				
1.1	Rregullimi i punishtës për punë dhe shenjëzimi i pikave nga projekti.	(komplet)	1.00	10.00	10.00
<b>Gjithsej POS 1:</b>					<b>10.00</b>
<b>Gjithsej POS 1:</b>					<b>10.00</b>
POS.	2. PUNËT E TERENIT DHE GJELBRIMI				
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
2.1	Largimi i mbeturinave, kositja e barit, në çmim duhet të llogaritet deponimi deri në një deponi legjave deri në 5km larg.	m <sup>2</sup>	1630.7	0.22	358.75
2.2	Furnizimi, transporti dhe shtruarja dhe rrafshimi i dhaut HUMUSOR në tërë sipërfaqen e parapare për gjelberim si dhe rrafshimi i saj. H=20cm	m <sup>3</sup>	77	2.00	154.00
2.3	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e barit anglez në mënyrë profesionale me fare 35 m <sup>2</sup> /3kg fara dhe rrafshim e terrenit me cilindër të dorës, dhe ujitja me ujë deri në kositjen e parë të barit.	m <sup>2</sup>	385	1.00	385.00
2.4	Gërmimi i dhut për hapjen e gropave për vendosjen e dheut për drunjet dekorative dimënsionet e hapjes janë 60x60x50cm <sup>3</sup> . Dheu i tepërt duhet të ngarkohet si dhe të deponohet në deponi të qytetit, në çmim të llogaritet dhe furnizimi me dheun humusor për mbjelljen e bimeve dekorative.	copë	20	2.00	40.00
2.5	Furnizimi transporti si dhe vendosjen e dheut të përshtrahem për drunjet dekorative BLI dimensionet e gropave janë 60x60x50cm <sup>3</sup> .	copë	20	2.00	40.00
2.6	Furnizimi transporti si dhe mbjellja e drunjëve dekorative të llojit BUN moshë e tyre duhet të jetë minimum tre vjeçare para mbjelljes. (Diametri i trungut duhet të jetë së paku 3cm, gjatësi së paku 250cm, ndërsa diametri i kurorës së paku 60cm).	copë	20	15.00	300.00
2.7	Furnizimi transporti si dhe mbjellja e drunjëve dekorative (gjelbrim i ulët i llojit Píshe) moshë e tyre duhet të jetë minimum tre vjeçare para mbjelljes. (Diametri i trungut duhet të jetë së paku 3cm, gjatësi së paku 150cm, ndërsa diametri i kurorës së paku 80cm)	cope	10	15.00	150.00
<b>Gjithsej POS 2:</b>					<b>1.427.75</b>
POS.	3. PUNËT E KUBZAVE TË BETONIT				
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
3.1	Gërmimi i dheut të haporis së li-të në thellësi deri në 30cm, ngarkimi dhe transporti në deponi në largësi deri në 5km.	m <sup>3</sup>	39	1.00	39.00



3.2	Furnizimi transporti dhe shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit të fraksionit Fr:(0-63)mm nën bazën me trashësi $t=25\text{cm}$ . Pas rrafshimit të bëhet ngjeshja e zhavorit me cilindër, ashtu që të arrihet moduli i shafitjes $M=60\text{Mpa}$ ( $600\text{kg}/1\text{cm}^2$ ).	$\text{m}^3$	32.5	7.00	227.50
3.3	Furnizimi transporti dhe shtruarja e zhavorit të fraksionit Fr:(0-32)mm nën bazën me trashësi $t=15\text{cm}$ . Pas rrafshimit të bëhet ngjeshja e zhavorit me cilindër, ashtu që të arrihet moduli i shafitjes $M=60\text{Mpa}$ ( $600\text{kg}/1\text{cm}^2$ ).	$\text{m}^3$	19.5	7.00	136.50
3.4	Furnizimi transporti si dhe montimi i gureve skajore prej betoni të klases C-30/37 me dim: $8 \times 20 \times 100\text{cm}$ , në bazën prej betoni të thate me trashësi $t=15\text{cm}$ .	$\text{m}^3$	167	8.00	1,336.00
3.5	Furnizimi, transporti si dhe shtruarja e kubazave me trashësi $t=8\text{cm}$ të klases C-30/37 pasi që të shtrohen duhet të bëhet mbushja e fugave me rreze të imet.	$\text{m}^3$	130	8.00	1,040.00
				Gjithsej POS 3:	2,779.00

4.PUNET E NDRIQIMIT					
POS.	Pershkrimi i Puneve	njësia	sasia	totali	totali
4.1	Hapja e kanaleve në stazat e ecejz si dhe pjesë tjera sipas detajeve të dhëna në projekt me makineri dhe dorë në thellësi të kanalit $h=60\text{cm}$ si dhe gjeresi $b=40\text{cm}$ për vendosjen e kablilit për furnizimin e shtyllave të ndriqimit me kablilo sipas projektit, në qmim duhet të parashihen edhe ngarkimi dhe transporti dheut të tepert deri në depot në largësi deri në $5\text{km}$ .	$\text{m}^3$	8.40	0.50	4.20
4.2	Mbulimi i kanalit me dheun e germuar me pare, pas vendosjes së kablilove dhe pjesëve tjera si shiritit parafajmruar etj, me dheun e germuar si dhe një shtresë zhavor me trashësi të zhavorit $t=10\text{cm}$ . Pas rrafshimit të bëhet ngjeshja e zhavorit me cilindër, ashtu që të arrihet moduli i shafitjes $M=60\text{Mpa}$ ( $600\text{kg}/1\text{cm}^2$ ).	$\text{m}^3$	8.40	0.50	4.20
4.3	Furnizimi, transportimi dhe montimi i kablilit elektrik $3 \times 1.5\text{mm}^2$ prej kutis shpërndarës në qdo shtyllë për ndriqim me të gjitha punët tjera përcjellëse, kabli duhet të futet në gypin e brinjëzuar $\varnothing 22\text{mm}$ , ku në qmim duhet të përfshihet edhe gypit i brinjëzuar.	$\text{m}^3$	60.00	2.00	120.00
4.4	Furnizimi, transportimi dhe montimi i shtyllave prej qeliku të gjavarnizuar me diametër $\varnothing 120\text{mm}$ dhe lartësi të shtyllës $h=4\text{m}$ sipas detajeve të dhëna në projekt, në qmim duhet të parashihet edhe ankerimi me pilatë qeliku dhe bulna në bazat e betonit.	copë	4.00	100.00	400.00
4.5	Furnizimi, transportimi dhe montimi i poqave elektrik LED me min 80 drita të vogla në një poq apo të ngjashme me karakteristikë dhe ndriqim të nyetë, forma dhe dizajni duhet të jenë sipas detalit në projekt.	copë	4.00	5.00	20.00
4.6	Furnizimi, transportimi dhe montimi i shiritit FeZn $20 \times 2.5\text{mm}$ , për tokezimin e qdo llampe elektrike me një distancë nga dritë min $2\text{m}$ si dhe shtangimi në shtyllën elektrike me bulona adekuat për këtë pozicion.	$\text{m}^3$	24.00	2.00	48.00
4.7	Furnizimi, transportimi dhe betonimi i bazës së shtyllave elektrike me beton MB-30 Mpa me dimensione $40 \times 40 \times 40\text{cm}$ si dhe betonimi i bazës së kutis shpërndarëse me dimensione $40 \times 100 \times 40\text{cm}$ me të gjitha punët tjera përcjellëse.	$\text{m}^3$	2.64	50.00	132.00
				Total 5:	728.4

5. ULESËT DHE SHPORTAT	
POS.	



5.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulseve me profile metalike si dhe me listela druri . Sipas projektit, ULSET duhet të vendosen mbi dyshemene e cila eshte e shtruar me kubza betoni. Në çmim të llogaritet dhe pasttrimi i terenit.	copë	7	77.00	539.00
5.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulses me profile metalike si dhe me listela druri . Sipas projektit, tavolina duhet të ketë të vizatuar tabelen e shahut duhet të vendosen mbi dyshemene e cila është e shtruar me kubza betoni. Në çmim të llogaritet dhe pasttrimi i terenit.	copë	1	189.00	189.00
5.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i shportave për mbeturinat me dim 60x60x80 lloji i shportës së specifikuar nga projekti.	copë	5	50.00	250.00
				Gjithsej POS 5:	978.00

**6. RRETHOJAT**

**RRETHOJA ( Në çmim të përfshihet saldimi, bulonat.Ngryra në dy shtresa anti korroduese, ngryra e bardhë sipas specifikimeve në projekt, si dhe aksesoret që shërbejnë sipas specifikacioneve në projekt)**

6	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
6.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i rethojve metalike me lartësi h=45cm Korniza e rethojave të punohet me profile prej metali me dim 40x40x3mm, ndërsa mbushja e rethojave të punohet me profile prej metali me dim 30x20x2mm.Në çmim të llogaritet lyerja me ngjyrë antikorozive dhe me ngjyrë të yndyrshme dhe ate në dy shtresa.Nunancën e ngjyrës e cakton investitori.	m'	61	25.00	1,525.00
6.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i derës metalike me dimensione 45°150cm .Korniza e derës të punohet me profile prej metali me dim 40x40x3mm, ndërsa mbushja e rethojave të punohet me profile prej metali me dim 30x20x2mm.Në çmim të llogaritet lyerja me ngjyrë antikorozive dhe me ngjyrë të yndyrshme dhe ate në dy shtresa Nunancën e ngjyrës e cakton investitori.	copë	1	100.00	100.00
				Gjithsej POS 4:	1,625.00

**7. PUNËT E PLATOS DHE SHKALLËVE**

POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
7.1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shkallëve me beton të klases C-30/37, sipas projektit. Në çmim të llogaritet, furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja e armatures, si dhe të gjitha punët latuese, montuese dhe performuese.	m'	1.2	250.00	300.00
7.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i ures nga struktura e drurit. Sipas projektit, Në çmim të llogaritet furnizimi, transporti si dhe montimi i pjesës kaluese të ures prej derrasave me trashësi t=12mm. Në çmim të llogaritet konstruksionit prej druri i ures me 4 traje 18x14cm prej druri halor të kategorisë së dytë.Në çmim të parashihet përpunimi i uresit derrasave si dhe lyerja e tyre me Sodolin dhe me ngjyrë të yndyrshme.	m²	3.75	100.00	375.00
				Gjithsej POS 5:	675.00



**REKAPITULIM**

1	PUNËT PREGADITORE		
2	PUNËT E TERENIT DHE GJELBRIMI	€	10.00
3	PUNËT E KUBZAVE TË BETONIT	€	1,427.75
		€	2,779.00

4	PUNET E NDRIQIMIT	€	728.40
5	ULESET DHE SHPORTAT	€	978.00
6	RRETHOJAT	€	1,625.00
7	PUNET E PLATOS DHE SHKALLEVE	€	675.00
		<b>TOTALI:</b>	<b>€ 8,223.15</b>
		<b>TVSH 18%</b>	<b>TVSH e llogaritur ne pos</b>
		<b>TOTALI ME TVSH:</b>	<b>€ 8,223.15</b>



## Paramasa dhe Paralogaria

### PARK REKREATIV "BRESTOC"


Verëjtje: Kontraktori duhet patjetër t'iu referohet Specifikimeve Gjenerale dhe detaleve. Çmimet duhet të përfshijnë furnizimin, transportin dhe instalimin/finalizimin e të gjitha materialeve. Kontraktori duhet të dorëzojë Deklaratat e Konformitetit për të gjitha materialet e përdorura në këtë projekt. Për të gjitha punët e ekzekutuara, patjetër duhet të bëhen testet paraprake.

1. PUNËT PREGADITORE					
POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Mobilizimi i ndërmarrjes dhe rregullimi i punishtës për ekzekutimin e punëve në pastrimin e dheut për rregullimin e parkut	(komplet)	1.00	50.00	50.00
<b>Gjithsej POS 1:</b>					<b>50.00</b>
2. PUNËT E TERENIT DHE GJELBRIMI					
POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
2.1	Largimi i mbeturinave, kositja e barit, në çmim duhet të llogaritet deponimi deri në një deponi legave deri në 5km larg.	m <sup>2</sup>	65	0.25	16.25
2.2	Furnizimi, transporti dhe shtruarja dhe rrafshimi i dheut HUMUSOR në tërë sipërfaqen e parapare për gjelberim si dhe rrafshimi i saj.	m <sup>2</sup>	29	1.00	29.00
2.3	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e barit anglez në mënyrë profesionale me fare 35 m <sup>3</sup> /3kg fara dhe rrafshim e terrenit me cilindër të dorës, si dhe ujë me ujë deri në kositjen e parkut të barit.	m <sup>2</sup>	29	1.00	29.00
2.4	Gërmimi i dhut për hapjen e gropave për vendosjen e dheut për drunjet dekorative dimensionet e hapjes janë 60x60x50cm'. Dheut i tepërt duhet të ngarkohet si dhe të deponohet në deponi të qytetit. Në çmim të llogaritset dhe furnizimi me dheut humusor për mbjelljen e bimëve dekorative.	copë	5	2.00	10.00
2.5	Furnizimi transporti si dhe vendosjen e dheut humusor për drunjet dekorative CATALPA dimensionet e gropave janë 60x60x50cm'.	copë	5	2.00	10.00
2.6	Furnizimi transporti si dhe mbjellja e drunjëve dekorative të llojit BLIN masha e tyre duhet të jetë minimum tre vjeqare para mbjelljes. (Diametri i trungut duhet të jetë së paku 3cm, gjatësi së paku 250cm, ndërsa diametri i kurorës së paku 60cm).	copë	5	15.00	75.00
2.7	Furnizimi transporti si dhe mbjellja e drunjëve dekorative (gjelbrim i ulët) masha e tyre duhet të jetë minimum tre vjeqare para mbjelljes. (Diametri i trungut duhet të jetë së paku 3cm, gjatësi së paku 150cm, ndërsa diametri i kurorës së paku 80cm).	copë	8	15.00	120.00
<b>Gjithsej POS 2:</b>					<b>289.25</b>
punët e betonit					
POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
3.1	Gërmimi i dheut të kështjorës së tii-të në thellësi deri në 30cm, pastrimi dhe transporti në deponi në largësi deri në 5km.	m <sup>3</sup>	12	0.50	6.00
3.2	Furnizimi transporti dhe shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit të fraksionit Fr:(0-63)mm nën bazën me trashësi t=25cm'.	m <sup>3</sup>	10	5.00	50.00

3.3	Furnizimi transporti dhe shtruarja e zhavorit të fraksionit Fr:(0-32)mm nën bazën me trashësi t=15cm. Pas rrafshimit të bëhet ngjeshja e zhavorit me cilindër, ashtu që të arrihet moduli i shpërthimit M=60Mpa (600kg/1cm <sup>2</sup> ).	m <sup>3</sup>	6	5.00	30.00
3.4	Furnizimi transporti dhe shtruarja e zhavorit të fraksionit Fr:(4-8)mm nën bazën me trashësi t=5cm, para montimit të kubëzave.	m <sup>3</sup>	10	5.00	50.00
3.5	Furnizimi transporti si dhe montimi i gureve skajore prej betoni të klases C-30/37 me dim: 20x10x100cm <sup>3</sup> , në bazën prej betoni të thatë me trashësi t=15cm.	m <sup>3</sup>	43	4.50	193.50
3.6	Furnizimi, transporti si dhe shtruarja e kubëzave me trashësi t=8cm të klases C-30/37, pasi që të shtrohen duhet të bëhet mbushja e fugave me rreze të imet.	m <sup>2</sup>	40	7.00	280.00
Gjithsej POS 3:					609.50

4. RRETHOJAT					
POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i rethojve metalike me lartësi h=45cm. Korniza e rethojave të punohet me profile prej metalli me dim. 40x40x3mm, ndërsa mbushja e rethojave të punohet me profile prej metalli me dim. 30x20x2mm. Në çmim të logaritit lyerja me ngjyrë antikorozive dhe me ngjyrë të yndyrshme dhe ato në dy shtresa. Nunancën e ngjyrës e cakton investitori.	m <sup>2</sup>	65	25.00	1,625.00
Gjithsej POS 4:					1,625.00

5. PUNET E NDRIQIMIT					
POS.S	Përshkrimi i Puneve	njësia	sasia	totali	totali
1	Hapja e kanaleve në stazat e ecejs si dhe pjese tjera sipas detajeve të dhëna në projekt me makineri dhe dorë në thellësi të kanalit h=60cm <sup>3</sup> si dhe gheresi b=40cm <sup>3</sup> për vendosjen e kablilit për furnizimin e shtyllave të ndriqimit me kablo sipas projektit, në çmim duhet të parashihen edhe ngarkimi dhe transporti i dheut të tepert deri në deponi në largësi deri në 5 km.	m <sup>3</sup>	2.64	0.50	1.32
2	Mbulimi i kanalit me dheun e germuar me për, pas vendosjes së kabllove dhe pjeseve tjera si shiritit paralajmruar etj, me dheun e germuar si dhe një shtresë zhavor me trashësi të zhavorit t=10cm. Pas rrafshimit të bëhet ngjeshja e zhavorit me cilindër, ashtu që të arrihet moduli i shpërthimit M=60Mpa (600kg/1cm <sup>2</sup> ).	m <sup>3</sup>	2.64	0.50	1.32
3	Furnizimi, transportimi dhe montimi i kablilit elektrik 3*1.5mm <sup>2</sup> prej kutisë shpërndarë në qdo shtyllë për ndriqim me të gjitha punët tjera përcjellëse, kablili duhet të futet në gypin e brinjëzuar Ø 22mm, ku në çmim duhet të përfshihet edhe gypin i brinjëzuar.	m <sup>3</sup>	23.00	2.00	46.00
4	Furnizimi, transportimi dhe montimi i kablilit elektrik 4*16mm <sup>2</sup> Al, prej rrejtës të qytetit deri në kutinë shpërndarë, kablili duhet të futet në gypin e brinjëzuar Ø 28mm, ku në çmim duhet të përfshihet edhe gypin i brinjëzuar.	m <sup>3</sup>	2.00	2.00	4.00
5	Furnizimi, transportimi dhe montimi i shtyllave prej qeliku të glavnizuar me diameter Ø120mm dhe lartësi të shtyllës h=4m sipas detajeve të dhëna në projekt, në çmim duhet të parashihen edhe ankerat me pllaka qeliku dhe bulna në bazën të qelikut në çmim të logaritit dhe furnizimi me poqin elektrik LED.	copë	2.00	125.00	250.00






## Paramasa dhe Paralogaria

### NDËRTIMI I KËNDIT REKREATIV NË VRAJAK

Verejtje: Kontraktori duhet patjetër t'iu referohet Specifikimeve Gjenerale dhe detaleve. Cmimet duhet te perfshtjne furnizimin, transportin dhe instalimin/finalizimin e te gjitha materialeve. Kontraktori duhet te dorëzoje Deklaratat e Konformitetit per te gjitha materjalet e perdorura në këtë projekt. Për të gjitha punët e ekzekutuara, patjetër duhet të bëhen testet paraprake.

1. PUNËT PREGADITORE					
POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Cmimi	Totali
1.1	Mobilizimi i ndërmarjes, Rethimi i punishtes për ekzekutimin e punimeve në Pastrimin e dheut për ndërtimin e këndit rekreativ.	(komplet)	1.00	10.00	10.00
Gjithsej POS 1:					10.00
2. PUNËT E TERENIT DHE GJELBRIMI					
POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Cmimi	Totali
2.1	Pastrim, nivelizimi si dhe zhvendosja e dheut të kategorisë së III dhe IV-te . (Për gjith sipërfaqen e paraprakë në projekt, të bëhet shtyrja e dheut deri në nivelizimin e gjith hapësirës së paraprakë në projekt).	m <sup>3</sup>	300	0.35	105.00
2.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e HUMUSIT ne tere sipërfaqen e parapara per gjelberim si dhe rrafshimi i saj. (Për gjith sipërfaqen e barit , humusi të flogaritet në një trashësi prej 30cm).	m <sup>3</sup>	300	1.00	300.00
2.3	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e barit anglez ne menyre profesionale me fare 35 m <sup>2</sup> /3kg fara dhe rrafshim e terrenit me cilindër te dorës, dhe ujtja me uje deri ne kositjen e pare te barit.	m <sup>2</sup>	870	0.50	435.00
2.4	Gërmimi i gropave për vendosjen e dheut per drunjet dekorative dimensionet e hapjes jane 60x60x50cm. Dheu i tepërt duhet të ngarkohet si dhe të deponohet në deponi të qytetit si dhe furnizimi me dheun e pershtatashen per mbjelljen e bimëve dekorative.	copë	12	2.00	24.00
2.5	Furnizimi transporti si dhe vendosjen e dheut të pershtatshëm për drunjet dekorative BLI. Dimensionet e gropave jane 60x60x50cm.	copë	12	2.00	24.00
2.6	Furnizimi transporti si dhe mbjellja e drunjeve dekorative te llojit BLIN masha e tyre duhet të jet minimum tre vjeqare para mbjelljes. (Diametri i trungut duhet të jetë së paku 3cm, gjatësi së paku 250cm, ndërsa diametri i kurorës së paku 60cm).	copë	12	15.00	180.00
2.7	Furnizimi transporti si dhe mbjellja e drunjeve dekorative (gjelbrim i ulët i llojit Plishe) masha e tyre duhet të jet minimum tre vjeqare para mbjelljes. (Diametri i trungut duhet të jetë së paku 3cm, gjatësi së paku 150cm, ndërsa diametri i kurorës së paku 80cm).	copë	5	15.00	75.00
2.8	Gërmimi i kanalit për gypin e ujrave atmosferike në kategorinë III-IV me makinë dhe me dorë me gjerësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thehtësi sipas profilit gjatësor. Thehtësia mesatare h=50 cm.	m <sup>3</sup>	11.5	0.25	2.88
2.9	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave prej betonit të armuar Ø150/1000mm për pusetat e ulësve dhe t'vë (elemente të parafabrikura).	copë	15	25.00	375.00
Gjithsej POS 2:					1,520.88



3. PUNET E KUBZAVE TE BETONIT					
POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njesia	Sasia	Cmimi	Totali
3.1	Furnizimi transporti dhe shtruarja e zhavorit të fraksionit Fr.(0-32)mm' nën bazën me trashësi t=20cm'. Pas rrafshimit të bëhet ngjeshja e zhavorit me cilindër, ashtu që të arrihet moduli i shpirtjes M=60Mpa (600kg/ 1 cm2)	m <sup>3</sup>	12	5.00	60.00
3.2	Furnizimi transporti dhe montimi i gurëve skajorë prej betonit të klases C-35/37 me d'im. 8x20x100cm në bazament prej betoni me trashësi 15cm, gjithnjë sipas rregulloreve EN 1340 për këtë pozicion.	m <sup>3</sup>	67	4.50	301.50
3.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i kubzave prej betoni të klases C-35/37 me trashësi t=8cm' në çmim të llogaritet edhe furnizimi dhe shtruarja e rërës me frak. (4-8)mm me trashësi prej 5cm si dhe mbushja e fugeve me rërë, gjithnjë sipas rregulloreve EN 1338 duke përfshirë edhe zgjerimet dhe lvoçet në trotuare.	m <sup>2</sup>	60	7.00	420.00
				Gjithsej POS 3	781.50

4. PUNET E NDRIQIMIT					
POS.	Përshkrimi i Puneve	njesia	sasia	totali	totali
4.1	Hapja e kanaleve në stazat e ecejs si dhe pjeste tjera sipas detajeve të dhëna në projekt me makineri dhe dorë në thellësi të kanalit h=60cm' si dhe gheresi b=40cm' për vendosjen e kablilit për furnizimin e shtyllave të ndriqimit me kablo sipas projektit në qmim duhet të parashihen edhe hudhajt e sasis se dheut të tepert deri në deponi në largësi deri në 5 km'.	m <sup>3</sup>	3.60	2.00	7.20
4.2	Mbyllja e kanalit pas vendosjes së kabllove dhe pjesëve tjera si shiritit paralel mruet etj, me dheut e germuar si dhe një shtres zhavor me trashësi të zhavorit t=10cm'. Pas rrafshimit të bëhet ngjeshja e zhavorit me cilindër, ashtu që të arrihet moduli i shpirtjes M=60Mpa (600kg/ 1 cm2).	m <sup>3</sup>	3.60	2.00	7.20
4.3	Furnizimi, transportimi dhe montimi i kablilit elektrik 3*1.5mm' prej kutis shpërndarës në qdo shtyllë për ndriqim me të gjitha punët tjera përcjellës, kabli duhet të fuset në gypin e brinjëzuar Ø 22mm', ku në qmim duhet të përfshihet edhe gypi i brinjëzuar.	m'	23.00	2.00	46.00
4.4	Furnizimi, transportimi dhe montimi i kablilit elektrik 4*6mm' prej rrejtik të qytetit deri në kutin shpërndarës, kabli duhet të fuset në gypin e brinjëzuar Ø 28mm', ku në qmim duhet të përfshihet edhe gypi i brinjëzuar.	m'	10.00	2.00	20.00
4.5	Furnizimi, transportimi dhe montimi i shtyllave prej qeliku të glavarizuar me diameter Ø120mm' dhe lartësi të shtyllës h=4m' sipas detajeve të dhëna në projekt, në qmim duhet të parashihet edhe ankerimi me pillaqë qeliku dhe bulona në bazat e betonit.	copë	2.00	125.00	250.00
4.5	Furnizimi, transportimi dhe montimi i poqave elektrik LED me min 80 drita të vogla në një poq apo të ngjashme me karakteristika dhe ndriqim të njete, forma dhe dizajni duhet të jenë sipas detajit në projekt.	copë	2.00	5.00	10.00
4.6	Furnizimi, transportimi dhe montimi i shiritit FeZn 1*3.5mm; për tokezimin e qdo poqi elektr me një distan nga drit min 2m' si dhe shtrëngimi në shtyllën elektrime me bulona ndehet në këtë pozicion.	m'	12.00	3.00	36.00



4.7	Furnizimi, transportimi dhe betonimi bazes se shtyllave elektrime me beton MB-30 Mpa me dimensione 40*40*40 cm' si dhe betonimi i bazes se kutis shperndarse me dimensione 40*100*40 cm' me te gjitha punet tjera pericellise.	m3	0.12	50.00	6.00
<b>Total 5</b>					<b>382.40 €</b>

5. OBJEKTET					
POS.	Pershkrimi i pozicionit	Njesia	Sasia	Çmimi	Totali
5.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulëseve për pushim. Konstruksioni i ulëseve të punohet prej profileve metalike 40x60x4mm, si dhe pjesa e ulëseve dhe e mbështetjes prej listellave te drurit me dim - 40x60mm, të lyera me lak, drurit të jetë halorë i kategorisë së dytë, me sipërfaqe të përpunuara dhe të lëmuara, si dhe të përforcuara me bulona në profil metalik. Profilet metalike të ngjyrosen me ngjyrë antikorozive dhe ngjyrë të yndyrshme dhe atë në dy shtresa. Dimenzionet e ulses jane 180x65x85cm.	cope	4	100.00	400.00
5.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i shportave për mbeturina, me konstrukcion mbajtes nga profilet metalike 20x20x2.5mm, pjesa e mbrendëshme të punohet prej llamarinë të zinguar, ndërsa ana e jashtëme të punohet prej listellave të drurit halorë me dim- 3x5cm të lyera me lak, diametri Ø60mm dhe lartësia 80cm.	cope	2	50.00	100.00
5.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i tavolinave me profile metalike si dhe pjesa e sipërme të jetë prej listellave të drurit halorë me dim - 40x60mm, të lyera me lak si dhe të përforcuara me bulona në profil metalik. Profilet metalike të ngjyrosen me ngjyrë antikorozive dhe ngjyrë të yndyrshme dhe atë në dy shtresa. Dimenzionet e ulses jane 90x180x65cm.	cope	2	200.00	400.00
Gjithsej POS 6:					900.00

REKAPITULIM			
1	PUNËT PREGADITORE	€	10.00
2	PUNËT E TERENIT DHE GJELBRIMI	€	1,520.88
3	PUNËT E KUBZAVE TË BETONIT	€	781.50
4	PUNËT E NDRIQIMIT	€	382.40
5	OBJEKTET	€	800.00
		<b>TOTALI:</b>	<b>€ 3,594.78</b>
		<b>TVSH 18%:</b>	<b>TVSH e llogaritur ne pos</b>
		<b>TOTALI ME TVSH:</b>	<b>€ 3,594.78</b>



## Paramasa dhe Paralogaria

### PARAMASA DHE PARALOGARIA PËR PARKUN TEK SHKOLLA- BEKIM SYLKA

